



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 41 datë 26-03-2026

**PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË FONDIT PREJ 801,777 LEKË PËR  
PUNIME MIRËMBAJTJE NË SPORTI I VOGËL**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK “Për miratimin e rialokimit të fondit prej 801,777 lekë për “Punime mirëmbajtje në sporti i vogël”, duke iu referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, ligjit nr 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 « Për financat e vetëqeverisjes vendore », i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 14.1.2026 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, VKB nr. 27 datë 25.2.2026 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2025 të Bashkisë, institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2026”, shkresës me nr. Reference LT-TAPAL-ALSK-02613 datë 24.3.2026, si dhe urdhri nr. 286 datë 12.3.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për një ndryshim në urdhërin nr. 235 datë 6.3.2026”, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë rialokimin e fondit prej 801,777 lekë për “Punime mirëmbajtje në sporti i vogël”, si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:  
PAKËSOHET Prog. AI122 00 V066AAB 05 Art. 2310000 -801,777 lekë Bashkia  
SHTOHET Prog. AE122 00 P452AAC 05 Art. 2310000 +801,777 lekë Bashkia
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Prokurimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Eva NAÇI**

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 5

Zbardhur më datë 26-03-2026



**KRYETAR**

**Ana Verushi**